

EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7890
E martë, 24 shtator 2024
Çmimi 0.50

26 vjet nga rënia e heronjve Fehmi dhe Xhevë Lladrovci dhe dëshmorëve të tjerë | FAQE 6



KOSOVA KA RËNIE SA I PËRKET LIRISË SË MEDIAS DHE SIGURISË SË GAZETARËVE | FAQE 4-5



Gjatë vitit 2023 Kosova ka përfjetuar rënie të paparë sa i përket sigurisë së gazetarëve dhe lirisë së medieve, ndërsa sfidë ka qenë raportimi nga

veriu i vendit, ku gazetarët atje janë sulmuar dhe kërcënuar. Kështu u tha në publikimin e reportit vjetor "Treguesit e nivelit të lirisë së

medieve dhe sigurisë së gazetarëve", organizuar nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK)

DEPUTETI I KANTONIT JURA NË ZVICËR THOTË SE THAÇI PO MBAHET NË HAGË SÌ NË PRAKTIKAT E NJË REGJIMI TOTALITAR | F. 3



SHQIPTARËT E LUGINËS MARSHOJNË PËR "IDENTITET DHE DINJITET" DHE KUNDËR DISKRIMINIMIT | F. 3



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xheqisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mot: +377 44 501289
E-mail: renova@m.t.net.mk

NDËRTIM PROJEKTIM
PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 870 | 045 500 870
044 500 870 | 049 500 870

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AKTUALE



TRUMPI THOTË SE, NËSE HUMBET NË NËNTOR, S'DO TË GAROJË PËR PRESIDENT PËRSËRI | F. 2

TË ENJTEN KUVENDI MBLIDHET NË SEANCË PLENARE | F. 5

HARADINAJ PREMTON SE PAGA MË E ULËT NË FSK DO TË JETË 1 000 EURO | F. 7

LARGIMI I QYTETARËVE TË KOSOVËS NË HESHTJE, MË I RREZIKSHËM SE EKSODI | F. 7

EKONOMI



KURTI TAKON PËRFAQËSUESIT E SHOQATAVE TË DIASPORËS NË ITALI: MËRGATA, URË EKONOMIKE | F. 8

MINISTRI I BUJQËSISË: KEMI PESËFISHUAR MBËSHTELJEN PËR FERMERËT ORGANIKË | F. 8

SPORT



JANUZI PASI MERR ÇMIMIN 'YLLI I JAVËS': LLAPI LUFTON PËR TITULL | F. 10

Trumpi thotë se s'do të garojë për president përsëri, nëse humbet në nëntor

UASHINGTON, 23 SHTATOR - Ish-presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, ka thënë se nuk beson se do të garojë për president në vitin 2028 nëse pëson disfatë në zgjedhjet presidenciale amerikane më 5 nëntor.

Trump, 78 vjeç, ka qenë kandidat i republikanëve në tri palë zgjedhje presidenciale radhazi dhe e ka ndryshuar partinë dukshëm në tetë vjetët e fundit.

Në një intervistë për "Sinclair Media Group" të dielën, Trump u pyet nëse parashikon se do të garojë edhe një herë në rast se humbet kundër kandidates demokrate Kamala Harris. "Jo, mendoj se jo. Me kaq do të mbarojë. Nuk mendoj se do ta bë", u përgjigji Trump.

Por, ai shtoi se "shpresoj se ne do të jemi shumë të suksesshëm" në zgjedhjet e nëntorit.

Ligji amerikan ua ndalon presidentëve mbajtjen e mëshumëse dy mandateve, prandaj Trumpi nuk do të garonte më 2028 as në rast fitoreje këtë vit.

Trumpi përballet me garë të fortë kundër demokrates, nënpresidentes amerikane Kamala Harris, pasi

sondazhet po tregojnë se gara mes tyre është tejet e ngushtë në shtetet kryesore, të cilat me gjasë do të janë vendimtare në përcaktimin e fituesit, edhe pse Harris ka filluar ta krijojë një epërsi në sondazhet gjithëkombëtare.

Trumpi e nisi fushatën e parë për t'u kthyer në Shtëpinë e Bardhë më 2020, në ditën e njëjtë që ishte inauguruar më 2017, ndërsa fushatën e dytë për t'u rizgjedhur e nisi para dy vjetëve, në nëntor 2022.

Trump rrallëherë e ka pranuar mundësinë e humbjes në zgjedhje. Ai ka vazduar të pretendojë rrejshëm se humbi më 2020 kundër presidentit Joe Biden për shkak të vjedhjes së votave dhe përballet me akuza përvepër penale në lidhje me përpjekjet e tij për ta zhbërrë rezultatin e atyre zgjedhjeve.

Ai i ka mohuar akuzat dhe e ka cilësuar aktakuzën kundër tij si sulm politik.

Ndërkohë, Harris, 59-vjeçare, e emërua kandidate e demokratëve pasi presidenti Joe Biden u tërroq nga gara muaj më parë.



SPD-ja e Scholzit i fiton zgjedhjet teksa ekstremi i djathë vazhdon rritjen


BERLIN, 23 SHTATOR - Derisa është larg kapercimit të vështirësive, kancelari i Gjermanisë, Olaf Scholz, mund të ndihet i lumtur së paku pas zgjedhjeve të së dielës në Brandenburg, landin e ish-Republikës Demokratike të Gjermanisë, i cili kufizohet me kryeqytetin federal, Berlin.

Partia e tij e Socialdemokratëve (SPD), e cila e ka udhëhequr këtë land që nga ribashkimi i Gjermanisë, ia doli të zëré vendin e parë përsëri, pasi kishte ngelur mbrapa partisë së ekstremit të djathë, Alternativa për Gjermaninë (AfD), pothuajse gjatë gjithë fushatës.

Në fund, SPD-ja i fitoi 30.9 për qind të votave, duke shënuar përmirësim kahasuar me 26 për qind sa i kishte fituar para pesë vjetëve, dhe e la AfD-në mbrapa në vendin e dytë me 29.2 për qind të votave.

Ky rezultat është lehtësim afatshkurtër për Scholzin në shumë mënyra. Ai jeton në Potsdam, kryeqytetin e Brandenburgut, dhe partia e tij më në fund shënoi një fitore pas rezultateve të tmerrshme në Turingi dhe Saksoni, dy landët e ish-Gjermanisë Lindore, para tri javëve, ku mezi mbijetoj.

Në javët e fundit ka pasur seç herë e më shumë pikëpyetje për atë se sa gjatë mund të udhëheqë qeveria federale pas rezultateve kaq të dobëta. Megjithatë, tanë duket se të paktën mund të arrijë disi në zgjedhjet e përgjithshme, të planifikuara për shtatorin e vitit



2025.

Cështja, megjithatë, është se sa shumë merita duhet të marrë Scholzi për këtë rezultat. Ai e ka ndryshuar tonin në javët e fundit, në përpjekje për t'i adresuar druajtjet rreth emigrimit dhe skepticizmit për Ukrainën, të cilat mbizotërojnë në pjesë të mëdha të elektoratit, kryesisht në pjesën lindore të vendit.

Ai ka folur më zëshëm rishtazi përbisedime për paqe, në të cilat duhet të përfshihet edhe Rusia, ndërsa në fillim të shtatorit ai i riktheu kontrolllet kufitare në të gjithë kufijtë e Gjermanisë, në

tentim për ta luftuar emigracionin pas një sulmi vdekjeprurës me thikë në qytetin perëndimor, Solingen, në gusht, për të cilin përgjegjësinë e mori Shteti Islamik. Prapëseprapë, në shumë aspekte, rezultati përfundimtar duket të jetë arritur falë një kombinimi mes njërezye që kanë votuar për partinë e tij si zgjidhja e fundit për parandaluar AfD-në nga fitori dhe popullariteti i kryeministrat të tanishëm të Brandenburgut, Dietmar Woidke, i cili, edhe pse është bashkëpartiak i Scholzit, e shpërfilli atë gjatë fushatës dhe e

kritikoi qeverinë federale. Gjithashtu, ia vlen të theksohet se dy partnerët e koalicionit federal, të Gjelbrit dhe Partia Liberale FDP, dëshuan plotësisht në Brandenburg. E para i mori 4.1 për qind të votave dhe kështu dështoi ta kalojë pragun prej 5-përqindësh për t'u përfaqësuar në parlamentin e landit, ndërsa FDP-ja i mori 0.8 për qind të votave, që është rezultati më i dobët ndonjëherë në zgjedhje rajonale. Dhe derisa AfD-ja dështoi të dalë e para në Brandenburg, ajo shënoi rritje përsëri. Nuk ka dyshim se kjo parti është prapëseprapë fituesja

më e madhe pas zgjedhjeve në landët lindore në shtator. Ajo përfundoi në vendin e dytë shumë pranë fituesit në dy prej tyre dhe u bë partia e parë e ekstremit të djathë prej Luftës së Dytë Botërore që e fiton një land, Turinginë. Natyrish, pjesa lindore e vendit dallon shumë, sepse një pjesë e madhe e elektoratit është kundër emigracionit dhe ka ndjenja më të ngrohta karshi Moskës.

Kjo u pasqyrua nga suksesi i partisë së re majtiste, BSW (Sahra Wagenknecht Alliance), e cila doli e treta në Brandenburg me 13.5 për qind të votave të fituara, dhe ka qëndrime shumë të ngjashme politike me AfD-në.

Në nivel federal, partitë e ekstremit të majtë dhe ato të ekstremit të djathë mund t'i fitojnë një të tretat e votave. Ato, megjithatë, do të kenë ndikim në lojtarin më të madh ekonomik të BE-së para zgjedhjeve, duke i bërë trysni për emigracionin dhe Ukrainën.

Dhe kjo nuk po ndodh vetëm në Gjermani. Populisti çek Andrej Babis doli mirë në zgjedhjet rajonale të mbajtura fundjavën e njëjtë si votimi në Brandenburg, dhe ai duket të jetë në pozitë të mirë për t'u bërë kryeministër i vendit vitin e ardhshëm. Austria do të mbajë zgjedhje parlamentare fundjavën e ardhshme.

Atje, partia populiste e ekstremit të djathë, Partia e Lirisë (FPO), është duke prirë bindshëm në sondazhe. Evropa është duke i shikuar interesat e veta tani.

Deputeti i kantonit Jura në Zvicër thotë se Thaçi po mbahet në Hagë si në praktikat e një regjimi totalitar

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Raoul Jaeggi, deputet i kantonit Jura në Zvicër, ka reaguar në "Facebook" rrith Gjykatës Speciale, veçanërisht për paraburgimin e ish-presidentit Hashim Thaçi.

Procesi i tejzgjatur gjyqësor kundër ish-presidentit Thaçi konsiderohet si regjim totalitar dhe antidekompratik nga deputeti i kantonit Jura, Raoul Jeaggi, i cili është pjesë e legjislativit kantonal nga viti 2009. "Hashim Thaçi është paraburgosur përgatit katër vjet

në kushte që të kujtojnë praktikat e një regjimi totalitar, ku drejtësia preventive zvarritet pafundësish, duke shkelur parimet themelore të të drejtave të njeriut", ka shkruar Jaeggi. Sipas tij, ky paraburgim i zgjatur pa dënim përfundimtar jo vetëm që është i padrejtë, por ai minon vetë vlerat e demokracisë dhe respektimin e të drejtave individuale. "Është përgatitur se, ndryshe nga ata që kërkojnë t'i shpëtojnë drejtësisë, Hashim Thaçi dha dorëheqje si president i Kosovës



Raoul Jaeggi
6h · ...
Hashim Thaçi has been detained for nearly four years in conditions reminiscent of the practices of a totalitarian regime, where preventive justice stretches indefinitely, blurring the fundamental principles of human rights. This extended detention without permanent conviction is not only unfair, but it violates the very values of democracy and respect for individual rights.
It is striking to note that, unlike those seeking to escape justice, Hashim Thaçi has resigned as Kosovo's president to face the charges levied against him. This behavior is in contrast to the usual culprits, who use their power to avoid accountability. Thaçi chose to fully cooperate with the justice system, a rare and courageous gesture.
If Thaçi was guilty of the crimes he is accused of, it is surprising that he did not adopt the escape and self-defense strategy that so many other leaders accused of serious crimes have chosen. Instead, he voluntarily submitted himself to international justice, further proof of his willingness to prove his innocence. Such behavior deserves recognition and raises questions about the legitimacy of such a long preventive detention.
• See original · Rate this translation
2 shares
Like Comment Copy Share

përgatitur me akuzat ndaj tij. Kjo sjellje është e kundërtë me atë të autorëve tipikë, të cilët përdorin fuqinë e tyre për ta shmangur përgjegjësinë. Thaçi zgjodhi të bashkëpunojë plotësisht me drejtësinë, një gjest i rrallë dhe i guximshëm", ka shkruar Raoul Jeaggi, deputet

kantonal në Jura që nga viti 2009. Ai ka shtuar tutje se: "Nëse Thaçi ka qenë faktor për krimet për të cilat akuzohet, është përgatitur se ai nuk ka adoptuar strategjinë e ikjes dhe vetëmbrojtjes që kanë zgjedhur shumë liderë të tjerë të akuzuar për krimet për rëndë. Në vend të

kësaj, ai vullnetarisht iu dorëzua drejtësisë ndërkomëtare, një provë tjetër e dëshirës së tij përgatitur pafajësinë e tij. Në sjellje e tillë meriton të njihet dhe ngre pyetje në lidhje me legjimititetin e paraburgimit preventiv kaq të gjatë", ka shkruar Jeaggi.

Shqiptarët e Luginës marshojnë për "identitetin dhe dinjitetin" dhe kundër diskriminimit



PRISHTINË, 23 SHTATOR - Qindra shqiptarë nga Lugina e Preshevës në jug të Serbisë kanë marshuar të hënën përgatitur, siç kanë thënë ata, kundër diskriminimit dhe në kërkim të barazisë dhe të drejtave të shqiptarëve në Serbi. Një nga organizatorët e marshit tha se "nga këtu dërguan porosinë se shqiptarët duan barazi, se barazia padrejtësi nuk bëhet. Kërkosat e shqiptarëve janë të kamotshme. E kamotshme është edhe heshtja e shtetit dhe padrejtësia që po ua bën shqiptarëve".

Ajo tha se kërkosat janë kthimi i gjykatës, zbatimi i marrëveshjeve të deritashme, kthimi i adresave të shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, njohja e diplomave shkolllore dhe integrimi i shqiptarëve në organet shtetërore. Serbia e ka mohuar vazhdimisht se shqiptarët në këtë vend janë të diskriminuar. Ata marshuan nëpër qendrën e qytetit të Preshevës pranë institucioneve duke mbajtur pankarta me mbishkrime si: "Stop pasivizmit selektiv", "Duam

libra shqip" dhe "kthema adresën", si dhe të veshur me fanella me mbishkrimin "Përgatitet dhe dinjitet". Marshi, të cilit i prin përfaqësuesi i vetëm i shqiptarëve në Parlamentin e Serbisë, Shaip Kamberi dhe kryetarja e Preshevës, Ardita Sinani, ndaloj pranë ndërtesës së komunës së Preshevës, ku u këndua himni kombëtar shqiptar. Kjo është protesta e dyte e shqiptarëve të Luginës në dy muajt e fundit, pas asaj në Bujanoc në gusht.

BDI-ja: Shqiptarët nuk do të janë vegla të skenarëve të tjerëve!

SHKUP, 23 SHTATOR - Bashkimi Demokratik për Integrin, nëpërmjet një komunikate për medie, ka theksuar "se shqiptarët nuk do të janë vegla të skenarëve të tjerëve dhe përgatitë shqiptare në pushtet".

Nga BDI thonë se "në vend që të ndërtojnë politika që u shërbejnë interesave kombëtare të shqiptarëve, këto subjekte janë bërë vegla të forcave që synojnë t'i dëmtojnë interesat tonë". "Pas zbulimit të turpshëm të djeshëm, ku deklaratat e disa partive shqiptare dolën se janë shkruar në selitë e partive maqedonase dhe më pas

janë dorëzuar përgatitur sulm BDI-në dhe liderin tonë, Ali Ahmeti, duam të nënvojimë se ky akt ka shkaktuar zemërim dhe indinjatë të thellë në mesin e shqiptarëve. Shqiptarët nuk do të pranojnë kurrë që të përdoren si vegla në skenarë të shkruar në selitë e partive maqedonase. Në vend që të ndërtojnë politika që i shërbejnë interesave kombëtare të shqiptarëve, këto subjekte janë bërë vegla të forcave që synojnë t'i dëmtojnë interesat tonë. Ky është një sulm jo vetëm ndaj një partie apo një individ, por një përpjekje përgatitës ulur dinjitetin dhe aspiratat kombëtare të shqiptarëve", thuhet në

komunikatën e BDI-së. BDI-ja ka theksuar se mbetet e vendosur përgatitës e interesave të shqiptarëve, me transparençë dhe dinjitet. "Nuk do të lejojmë që këto manovra të ulëta të na ndalin në rrugën tonë drejt përbushjes së aspiratave të shqiptarëve përgatitës e barazi dhe përfaqësimi të drejtë. Ftojmë të gjithë qytetarët shqiptarë të vazhdojnë të qëndrojnë të bashkuar dhe vigjilentë ndaj këtyre përpjekjeve përgatitës e barazi dhe manipuluar opinionin publik. BDI-ja ka theksuar se këto manovra nuk do të ndërtojnë politika që i shërbejnë interesave kombëtare të shqiptarëve, këto subjekte janë bërë vegla të forcave që synojnë t'i dëmtojnë interesat tonë. Ky është një sulm jo vetëm ndaj një partie apo një individ, por një përpjekje përgatitës ulur dinjitetin dhe aspiratat kombëtare të shqiptarëve", thuhet në



dinjitet, gjithmonë duke respektuar vullnetin dhe aspiratat e popullit shqiptar", ka përfunduar komunikata e BDI-së.



Kosova ka rënie sa i përket lirisë së medias dhe sigurisë së gazetarëve

Gjatë vitit 2023 Kosova ka përjetuar rënie të paparë sa i përket sigurisë së gazetarëve dhe lirisë së medieve, ndërsa sfidë ka qenë raportimi nga veriu i vendit, ku gazetarët atje janë sulmuar dhe kërcënuar. Kështu u tha në publikimin e raportit vjetor "Treguesit e nivelit të lirisë së medieve dhe sigurisë së gazetarëve", organizuar nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK)

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) ka paraqitur të hënën reportin vjetor "Treguesit e nivelit të lirisë së medieve dhe sigurisë së gazetarëve", si dhe Indeksin e Sigurisë së Gazetarëve në Ballkanin Perëndimor për vitin 2023 në

kuadër të Platformës Rajonale SafeJournalists.

Raporti është hartuar nga hulumtuesja Getoarbë Mulliqi, në bashkëpunim me Leonita Morina, asistente e projekteve, dhe pëershkruan gjendjen e sigurisë së gazetarëve dhe çështjeve socio-ekonomike e politike në raport me lirinë e medias në Kosovë.

Gjetjet e raportit që fokusohen

në tre tregues, kornizën ligjore, pozitën e gazetarëve në dhomën e lajmeve, si dhe sigurinë e gazetarëve, u prezantuan nga Mulliqi, Morina, si dhe eksperti ligjor i raportit, Yll Zekaj. Sipas gjetjeve të këtij rapporti, Kosova ka përjetuar një rënie të paparë më herët sa i përket lirisë së medias dhe sigurisë së gazetarëve. Krahasuar me vitin 2022, ku janë

raportuar 33 raste, numri i sulmeve ndaj gazetarëve është rritur për 41, duke e bërë vitin 2023 vitin me numrin më të lartë të shkeljeve të lirisë së medias dhe sulmeve ndaj gazetarëve. Gazetarët që raportuan në komunat veriore janë përballur me kërcënimë për jetën, sulme verbale dhe fizike, si dhe dëmtim të pronave personale dhe profesionale. Gjithashtu, në qershor qeveria ndërmori hapa për ta revokuar licencën e operimit të një prej televizioneve më të mëdha kombëtare, Klan Kosova. Rishikimi i licencës erdhë si pasojë e gjetjeve në dokumentacionin e korporatës

pronare nga Ministria e Tregtisë, Ndërmarrësise dhe Industrisë. Organizatat e shoqërisë civile vendore, në bashkëpunim me praninë ndërkombëtare në Kosovë, arritën ta parandalojnë këtë vendim nga zbatimi, megjithatë kjo paraqet një kërcënim të paprecedent për lirinë e medias në Kosovë. Teksa si rekomandime të raportit u theksua nevoja që gazetarët t'i raportojnë të gjitha rastet e shkeljes së të drejtave të tyre, bashkëpunim më i mirë i institucioneve të Republikës së Kosovës me mediet, si dhe të krijohet sa më shpejt Sistemi i Menaxhimit të Lëndëve nga KGjK për rastet e gazetarëve.

Votohet buxheti i Mitrovicës së Jugut për vitin 2025, Hamza paralajmëron projekte të rëndësishme

MITROVICË, 23 SHTATOR - Kryetari i Mitrovicës së Jugut, Bedri Hamza, ka njoftuar përvotimin e buxhetit të komunës, duke paralajmëruar hapjen e rrugës "Ali Zeneli" dhe "shumë projekte të rëndësishme". "I lumtur që u votua buxheti i Mitrovicës së Jugut për vitin 2025 dhe që me votat e asamblistëve u krijuan mundësitet e hapjes së rrugës 'Ali Zeneli', ku jetojnë qindra familje, të cilën asnjë qeverisje lokale nuk kishte mundur ta hapte në këto dy dekada për shkak të vështirësive që janë të njobura për të gjithë mitrovicasit. Hapja e kësaj rruge do ta shkarkojë jashtëzakonisht shumë komunikacionin dhe do të hapë

perspektivë të re ekonomike për banorët e kësaj zone. Dhe, po ashtu, perspektivë të re do të hapin edhe shumë projekte të rëndësishme dhe me ndikim të madh në përmirësimin e jetës së qytetarëve që do të realizohen me buxhetin e miratuar për vitin e ardhshëm", ka thënë ai.

Hamza i ka falënderuar asamblistët e të gjitha subjekteve politike në Kuvendin e Mitrovicës së Jugut përvendimmarjen e përgjegjshme në të mirë të qytetarëve dhe komunës. "Me punë e përkushtim, duke i kuptuar drejt brengat e qytetarëve, ne po e përbushim synimin tonë për ndryshimin e Mitrovicës!", ka thënë Hamza.



Ambasadori Reka takon eurodeputetin austriak, i kërkon mbështetje për Kosovën

NJU-JORK, 23 SHTATOR - Shefi i Misionit në Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Nju-Jork, ambasadori Blerim Reka, ka pritur në takim eurodeputetin austriak Lucas Mandl, me të cilin ka diskutuar për zhvillimet në Kosovë, për mbështetjen e tij edhe në të ardhmen për shtetin e Kosovës. "Dje prita eurodeputetin austriak Lucas Mandl,

i cili në Nju Jork, po merr pjesë në samitin e OKB për të ardhmen (Summit of the Future). Duke i uruar rizgjedhjen në Parlamentin Evropian, i kërkova mbështetjen për Republikën e Kosovës, shtetin më pro-perëndimor të Ballkanit. Në emër të 'stabilokracisë', nuk guxon të flijohet demokracia, e të shpërblehet autokracia", ka shkruar Reka në "Facebook".



Të enjten Kuvendi mblidhet në seancë plenare



EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Të enjten, më 26 shtator, në orën 10:00, Kuvendi i Republikës së Kosovës do të mblidhet në seancë plenare për ta vijuar shqyrtimin e pikave të papërfundura në seancat e kaluara. Kështu vendosi të hënën Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e përbashkët me kryetarë të grupeve parlamentare, të drejtuar nga kryetari Glauk Konjufca. Seanca plenare e Kuvendit pritet të fillojë me emërimin e shtatë anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, për të vijuar me votimin e Projektligjit për

ratifikimin e Marrëveshjes së financimit, për programin e parë për "Financimin e politikave zhvillimore përfshirë efektivitetin fiskal, konkurrueshmërinë dhe rritjen e gjelbër", në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim, shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e amendamentimit të Marrëveshjes për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe organizatat e grupit të Bankës Botërore, si dhe shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë në mes të

Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për Projektin Energjia diellore fotovoltaikë në KEK - Porta Globale.

Pas votimit në lexim të dytë të Projektligjit për shëndetin riprodhues dhe fertilitetin të asistuar mjekësor, si dhe atij për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Zyrtarët Publikë, deputetët pritet të shqyrtojnë në lexim të dytë edhe tri projektligje të tjera: Projektligjin për Këshillin e Sigurisë të Republikës së Kosovës, Projektligjin përrugët, si dhe Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit përfshirë drejtat prônësore të shtetasve të huaj në

Republikën e Kosovës.

Në parim, ndërsa që pritet të votohet Projektligji përfshirë gjendjen civile dhe ai përfshirë provimin e maturës shtetërore, përfshirë vijuar me shqyrtimin e parë të Projektligjit përfshirë ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit përfshirë automjete, si dhe atë përfshirë menaxhimin e resurseve ujore.

Pikë e radhës e rendit të ditës do të jetë shqyrtimi i Programit Kombëtar përfshirë Integrin Evropian 2024-2028 ndërsa, pas saj, votimi i Projekt-rezolutës përfshirë provimin e gjetjeve të Raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit-DASH.

Pjesë e rendit të ditës të kësaj

seance janë edhe shqyrtimi i Projekt-Deklaratës përfshirë raportet e Republikës së Kosovës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, shqyrtimi i Projekt-rezolutës përfshirë adresimin e çështjes së emigrimit të qytetarëve nga Republika e Kosovës, shqyrtimi i Projekt-Rezolutës përfshirë tērheqjen e tri projektligjeve nga shqyrtimi në Kuvend, shqyrtimi i Projekt-Rezolutës përfshirë arratisjen e personave të dënuar - degradimi i institucioneve të sigurisë, shqyrtimi i Raportit me rekomandime përfshirë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit përfshirë sponsorizime në fushën e kulturës, rinasë dhe sportit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-116, shqyrtimi i Propozitës rezolutës përfshirë vlerësimin e punës së Agjencisë përfshirë Informim dhe Privatësi përfshirë vitin 2022, shqyrtimi i Raportit të Performancës së ndërmarrjeve publike përfshirë vitin 2022, raportimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës përfshirë progresin mbi zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshmës dhe reflektimin e Agjendës Transformuese të Kosovës në buxhet dhe politika qeveritare, si dhe themelimi i Komisionit Ad-Hoc përfshirë përgjedhjen e kandidatëve përfshirë anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, prej tyre, një nga komuniteti shqiptar dhe një nga komuniteti serb. Kryesia në këtë mbledhje shqyrtoi edhe çështje të tjera nga fushëveprimtaria e saj.

Ministrja Haxhiu dhe shefi i BE-së diskutojnë për rëndësinë e reformës në drejtësi

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka pritur të hënën në takim shefin e zyrës së BE-së në Republikën e Kosovës, Aivo Orav, të cilin i uroi mirëseardhje dhe sukses në detyrën e re. Gjatë këtij takimi ministra Haxhiu e njoftoi ambasadorin Orav përfshirë punën dhe arritjet e deritanishme në Ministrinë e

Drejtësisë brenda mandatit, duke theksuar këtu reformën në drejtësi, luftimin e korruptionit, adresimin e krimeve të luftës, parandalimin dhe adresimin e dhunës në familje dhe fuqizimin e Shërbimeve Sociale dhe Familjare si dhe ato të Profesioneve të Lira mes të tjerash. Në takim është diskutuar për

rëndësinë e reformës në drejtësi dhe përfshirë çështje të tjera në kuptim të bashkëpunimit në forcimin e rendit dhe sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës.

Në fund ministra Haxhiu falënderoi ambasadorin e ri të BE-së në Kosovë përfshirë gatishmërinë dhe vullnetin përfshirë bashkëpunim dhe mbështetje përfshirë Republikën e Kosovës.





Në Prizren përvrohet aparati i mamografisë

Prizren, 23 shtator - Në vazhdën e përpjekjeve për modernizimin e shërbimeve në qendrat e shëndetësisë publike në Komunën e Prizrenit, të hënën u përvurua aparati i mamografisë në Qendrën

Kryesore të Mjekësisë Familjare, investim i Drejtorisë së Shëndetësisë, që përkon me fillimin e "Tetorit Rozë", muajit të ndërgjegjësimit përkancerin e gjirit. Ky projekt i rëndësishëm

për mirëqenien e qytetarëve është metodë kyçe për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit, ndërsa, krahas shërbimeve të specializuara dhe cilësore, kontrolllet do të jenë falas për të gjithë.

Rahoveci dhe Haraçina bashkëpunojnë për një të ardhme të gjelbër

RAHOVEC, 23 SHTATOR - Kryetari i komunës së Rahovcit, Smajl Latifi, ka marrë pjesë në konferencën e projektit ndërkufitar "Be Clean, Be Green", i cili do të zbatohet në bashkëpunim me komunën e Haraçinës nga Maqedonia e Veriut, i finançuar nga Bashkimi Evropian. Sipas kryetarit Latifi, ky projekt dëshmon angazhimin e tyre përmbrnjën e mjedisit dhe për një të ardhme të qëndrueshme. "Falënderoj partnerët, veçanërisht komunën e Haraçinës dhe kryetarin Ridvan Ibraimi, për bashkëpunimin dhe

përpërkushtimin në këtë projekt. Në komunën e Rahovcit kemi nisur tashmë punimet përmirësimin e infrastrukturës, përfshirë ndërtimin e sistemeve bioseptike në gjashtë fshatra: Pastasel, Pataqan i Ulët, Pataqan i Epërm, Polluzhë, Retijë dhe Rahovec (Lagjja I). Ky projekt do të ndikojë drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së jetës për qytetarët tanë dhe do të kontribuojë në ruajtjen e burimeve tona natyrore. Së bashku do të vazhdojmë për një mëdës më të pastër dhe të qëndrueshëm", ka thënë Latifi.



Policia sekuestron tetë armë zjarri në rajonin e Prishtinës



PRISHTINË, 23 SHTATOR - Nga zyrtarët policorë të rajonit Prishtinës, gjatë javës së kaluar në lokacione të ndryshme e aksione të ndara, janë realizuar 233 urdhëresa të gjykatës, prej tyre 62 urdhëresa për veprë penale, ndërsa të tjera për kundërvajtje, seanca, verifikime etj.

Konform urdhëresave, pas

përfundimit të procedurave policore, personat e dënuar me burgim janë dërguar për vuajtje të dënimit, ndërsa personat e dënuar me gjobë janë liruar, pasi i kanë kryer obligimet e caktuara në urdhëresa. Aktivitetet policore janë shtrirë edhe në segmente të tjera të sigurisë. Gjatë periudhës së njëjtë janë

sekuestruar 8 armë zjarri, të llojeve dhe kalibrave të ndryshëm.

Ndërkaq aktivitetet policore në sferën e sigurisë në trafikun rrugor, në po të njëjtën periudhë kohore, kanë rezultuar me shqiptimin e 5 214 masave administrative me gjobë për lloje të ndryshme të kundërvajtjeve dhe shkeljeve të kodit rrugor.

Inspektorët e Drenasit dalin në terren, vizitojnë barnatoret

DRENAS, 23 SHTATOR - Drejtoria e Inspeksionit në komunën e Drenasit, në vazhdën e realizimit të planit, ka vazhduar mbikëqyrjen e barnatoreve lidhur me respektimin e orarit të punës si dhe kujdestarive. Në kuadër të vizitave të realizuara në qendrën e Drenasit si dhe në Komoran është konstatuar që disa subjekte tregtare nuk kanë respektuar orarin e kujdestarisë, ashtu siç është përcaktuar nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik. Këtyre subjekteve tregtare u janë

dhënë vërejtjet e para paralajmëruese, ndërsa në rast të mosrespektimit të orarit do të vazhdohet me masat e parapara me ligj. Drejtoria e Inspeksionit inkurajon të gjithë qytetarët që në rast të hasjes së ndonjë parregullsie të çfarëdo natyre lidhur me shërbimin e barnatoreve, ta njoftojnë Inspektoratin për zbatimin e ligjit. Bashkëpunimi i qytetarëve shton efikasitetin e inspeksionit.



Policia e Kosovës i arreston katër të dyshuar për trafikim të emigrantëve

Prishtinë, 23 shtator - Katër burra janë arrestuar të dielën për trafikim të emigrantëve, njoftoi Policia e Kosovës të hënën.

Të dyshuarit, shtetas të Kosovës, u kapën në Mitrovicë të Jugut nga oficerët policorë duke transportuar pesë shtetas të Jemenit, të cilët kishin përsynim t'i dërgonin drejt vendeve të Bashkimit Evropian.

Policia theksoi se ka bastisur një shtëpi dhe automjete, si dhe ka sekuestruar të holla dhe automjete. "Gjatë kontrollit të shtëpisë dhe automjeteve janë gjetur dhe sekuestruar: 6 280 euro, 7 300 lekë shqiptare, 140 CHF zvicerane dhe 4 automjete", thuhet në njoftim.

Policia tha se të arrestuarit janë dërguar në mbajtje. Që prej vitit 2015 shtetet e Ballkanit Perëndimor janë

shndërruar në qendër transiti për personat që ikin nga Lindja e Mesme dhe Afrika dhe që synojnë të arrijnë në shtetet e Bashkimit Evropian. Kosova ka qendra për pranimin e emigrantëve, por shumica e tyre e përdorin këtë shtet vetëm si transit për në BE.

Edhe në të kaluarën Policia e Kosovës ka arrestuar të dyshuar për trafikim të emigrantëve.



Reagim i KMDLNj-së: Kush do t'i ndihmojë të burgosurit në Kosovë?!

Javën e kaluar në Q.S. në Gjilan vdiq një i burgosur i moshës affersisht 80 vjeç, apo, që të jemi të saktë, i moshës 78 vjeçare. Sipas raporteve mjekësore i burgosuri ishte pranuar me probleme të rënda kardiak që edhe e shkaktuan vdekjen përkundër angazhimit të personelit shëndetësor të Qendrës së Paraburgimit në Pasjak të Gjilanit t'i shpëtojnë jetën. Rastet e përsëritura të vdekjes së të burgosurve për shkak të sëmundjeve të rënda duhet të zgjojë alarm te institucionet e Kosovës, përkatësisht te Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Drejtësisë që të marrin veprime të menjëherësme në mënyrë që të mbrohetjeta e personave të privuar nga liria përfaktin se që nga vendosja e tyre në këto institucione përkujdesja dhe përgjegjësia bie mbi këto ministri. Rastet e shpeshta të vdekjes së të burgosurve duhet të zgjojë nga

gjumi gjykatat që trajtojnë këto raste aq më parë që kemi të bëjmë me të burgosur me sëmundje të pashërueshme apo në moshë të pleqërisë së thelli. Këto raste duhet të trokasen edhe në ndërgjegjen e presidentes e cila, ndonëse ka të drejtë ekskluzive ligjore dhe kushtetuese deri më tani nuk ka falur asnjë të burgosur që nuk ka ndodhur as në regjimet më diktatoriale.

Nëse të burgosurit, për shkak se kanë rënë në kundërshtim me ligjin duhet të dënohen kjo nuk nënkupton se ata duhet të privohen nga të drejtat e njeriut të personave të privuar nga liria dhe nga mëshira e shtetit, që në raste të caktuara duhet të zbatohet.

E drejta për jetë dhe shërbime cilësore shëndetësore është e drejta kryesore e njeriut dhe mbi këto ngritën të gjitha të drejtat tjetra. Shërbimi Shëndetësor i burgjeve nuk ka kapacitet profesionale e as të tjera të trajtojë

rastet e rënda ndërkaq që përgjegjësia për vdekjen e të burgosurve adresohet te ky shërbim, pa asnjë arsyre dhe të drejtë. Për rastet e rënda, Shërbimi Shëndetësor i burgjeve varet nga Forenzika Psikiatrike apo QKUK sikur edhe nga Spitalet Rajonale që kanë kapacitet pranues shumë të reduktuar për pranim të të burgosurve sikur që për rastet me rrezikshmëri të lartë duhet një sigurim shëtë gjetë transportit dhe qëndrimit në institucionin shëndetësor. Gjykatat përkatëse shpërfillin skajshmërisht kërkesat e Shërbimit Shëndetësor të burgjeve për rastet me diagnozë terminale apo shkaku i pleqërisë së thelli andaj edhe kemi raste të shpeshtuara të vdekjes së të burgosurve.

Prandaj, KMDLNj, duke trajtuar të drejta e njeriut nga parimi i universalitetit dhe si të pandashme shpreh shqetësim të thelli përvdekjen e të burgosurve



për shkak të angazhimit të pamjaftueshmë të Ministrisë së Drejtësisë që e ka nën përgjegjësi Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe Ministrisë së Shëndetësisë që ka nën përgjegjësi Shërbimin Shëndetësor të burgjeve. KMDLNj fton Komisionin Parlamentar për të Drejtat e Njeriut që me urgjencë të trajtojë

këto raste sikur që, në bazë të mandatit që e ka t'i vizitojë të burgosurit me gjendje të rëndë shëndetësore dhe pleqëri të thelli përfaktin se atyre po u mohohen të drejta elementare të njeriut, e drejta për jetë dhe shërbime shëndetësore sikur që Ligji për Ekzekutim të Sanksioneve Penale po zbatohet në mënyrë selektive.

Largimi i qytetarëve të Kosovës në heshtje, më i rrezikshëm se eksodi

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gérxhaliu, ka thënë se largimi i qytetarëve të Kosovës në heshtje është më i rrezikshëm se eksodi. Ai ka theksuar se mungesa e stabilitetit politik dhe mungesa e perspektivës ekonomike dhe evropiane po e rrit ankthën e qytetarëve të Kosovës për të ardhmen e tyre.

"Masat ndëshkuese nga Bashkimi Evropian dhe paralajmërimet përluftë eventuale me Serbinë fusin ankth dhe panik te qytetarët. Në Kosovë po ndodh një largim masiv, por këtë herë në heshtje dhe pa shumë vëmendje. Pamjet nga pritet në Aeroportin 'Adem Jashari' dhe aeroporte të rajonit, në veçanti Aeroporti i Shkupit gjatë gjithë vitit, tregojnë përfjetojnë në vendin tonë", ka thënë ai.



reflektim i mungesës së perspektivës dhe ngufatjes që shumë të rind dhe profesionistë po përfjetojnë në vendin tonë", ka thënë ai.

Sipas tij, kjo ikje e heshtur përfaqëson një krisë të thelli mungese mundësish dhe shprese.

"Të rindje e diplomuar dhe

profesionistët po largohen pa zhurmë drejt vendeve të BE-së dhe përtet. Largimi i tyre është më i rrezikshëm se ndonjë eksod masiv, pasi ndodh pa u vënë re dhe pa reagim nga institucionet. Largimi po shkatërron ekonominë e Kosovës. Sektori privat po përballet me sfida të mëdha për të

gjetur punonjës të aftë, ndërkohë që bizneset po mbyllen për shkak të mungesës së fuqisë punëtore dhe klientëve. Ika e konsumatorëve dhe fuqisë blerëse po e varferon më tej ekonominë tonë, duke e bërë të varur nga remitancat", është shprehur ai. Njohësi i ekonomisë ka thënë se

fluturimet nga Aeroporti "Adem Jashari" janë rritur 60 % krasuar me vitin e kaluar, pa i përfshirë ata që largohen përmes Shkupit. "Ndërsa qeveria nuk ka marrë masa për ta adresuar këtë krisë, duket se priorititet e institucioneve janë të tjera. Përmes gjobave ndaj bizneseve duket se po kontribuojnë në zbrazjen e mëtejshme të vendit. Situatën aktuale e rëndon edhe më tepër lajmi se në verën e ardhshme është paralajmëruar zbatimi edhe i Sistemit të dytë Evropian të Informacionit dhe Autorizimit të Udhëtimit (ETIAS), i cili u kërkon udhëtarëve nga vendet që kanë regjim pa viza me BE-në, të aplikojnë online për lejen e hyrjes. Nëse kjo gjendje vazhdon, Kosova do të humbasë një pjesë të madhe të kapitalit të saj njerëzor, duke u kthyer në një vend me pak mundësi reale për të rinjtë dhe profesionistët. Ky largim i heshtur është një krisë që po minon themelët e shoqërisë dhe ekonomisë sonë", ka thënë Gérxhaliu.

Haradinaj premton se paga më e ulët në FSK do të jetë 1 000 euro

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se një numër i madh i ushtarëve e kanë lëshuar Forcen e Sigurisë së Kosovës në vitin 2023 dhe 2024. "Mbi 11 për qind e ushtarëve lëshuan FSK-në vetëm në 2023 dhe 2024. Kjo është alarmante. I ftoj të qëndrojnë, sepse ne do ta ndryshojmë gjendjen", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Ai ka thënë se në vitin 2023 numri i pjesëtarëve që e kanë

lëshuar FSK-në është 257. "Në vitin 2024, ka kaluar numri prej 200. I fundit nga ta më 19 shtator 2024. Shumica nga ta përmendin kushtet e vështira financiare dhe pagat e pamjaftueshme në arsyetimin pse lëshojnë Ushtrinë. Edhe pas 4 viteve të kësaj qeverie, numri i pjesëtarëve të uniformuar është nën 4.000, ndërsa forca rezervë e FSK-së është harruar pothuajse plotësisht", ka deklaruar Haradinaj.

Ai ka shtuar se është i shqetësuar seriozisht me këtë trajtim katastrofal që qeveria po i bën Ushtrisë sonë, të cilën me shumë mund kemi arritur ta mandatojmë më 2018. "Ftoj rininë t'i bashkohen FSK-së dhe ftoj pjesëtarët të qëndrojnë aty. Ne do ta përmirësojmë me urgjencë gjendjen e tyre financiare dhe kushtet elementare të punës. Qysh në muajt e parë të Qeverisë së re, paga më e ulët në FSK do të jetë 1000 euro", ka thënë Haradinaj.



Ministri i Bujqësisë: Kemi pesëfishuar mbështetjen për fermerët organikë

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Ministri i Bujqësisë, Faton Peci, ishte pjesëmarrës në konferencën e dytë për bujqësinë organike në Kosovë, me rastin e shënimit të Ditës Evropiane të Produktiveve Organike. Ai ka thënë se ministria që drejton ka pesëfishuar mbështetjen për fermerët organikë. "Kemi rritur përkrahjen 400 % si dhe kemi hartuar Planin Kombëtar për

Bujqësinë Organike 2023-2026, duke e harmonizuar atë me standarde BE-së. Përkushtimi ynë i përbashkët po jep rezultate konkrete. Vetëm gjatë vitit 2023 janë certifikuar 520 hektarë për prodhim organik, ndërsa eksportet organike kanë arritur vlerën prej 16.5 milionë eurosh. Falë bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë dhe shoqatat vendore, po ndërtojmë

një të ardhme të qëndrueshme për sektorin e bujqësisë organike në Kosovë", ka thënë Peci.

Kryetari i Shoqatës "Organika", Fatmir Krasniqi, ka thënë se kanë arritur suksese të mëdha në këtë fushë duke eksportuar produkte organike me mbi 15 milionë euro. Jean-Christophe Favre nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë ka

theksuar se edhe pse Kosova është vend i vogël, është e vendosur për t'i ndalur sfidat globale me zgjidhje të guximshme.

E drejtori i Caritas-it Zviceran në Kosovë, Gerhard Schaumberger, ka thënë se duke marrë parasysh ndryshmet e shumta globale, është e rendësishme të ketë rritje të konsumit të këtyre produkteve.



Kurti takon përfaqësuesit e shoqatave të diasporës në Itali: Mërgata, urë ekonomike

VENECIA, 23 SHTATOR

Kryeministri Albin Kurti është takuar me përfaqësues të shoqatave të diasporës së Kosovës në Venecia të Italisë. Në bashkëbisedimin e tyre, është diskutuar mbi të tashmen dhe të ardhmen e Kosovës, përparimin që ka njojur vendi në tri vitet e fundit dhe perspektivën për avancim të mëtejmë të zhvillimit ekonomik dhe investime, por edhe mirëgenie sociale. U bashkëbisedua edhe përmërgatën si urë ekonomike dhe kulturore ndërmjet shtetit të Kosovës dhe kombit shqiptar me Italinë dhe popullin italian.

Kryeministri radhitë indikatorët pozitivë dhe premtues ekonomikë, ku përmendi rritjen mesatare ekonomike 6.2 %,



dyfishimin e eksporteve dhe investimeve të huaja direkte, krijimin dhe shtimin e vendeve të reja të punës, me fokus në punësimin e të rinjve dhe grave,

rritjen e qarkullimit të bizneseve. Ai shtoi se si qeveri janë përkujdesur që zhvillimi ekonomik të shpërndahet te të gjithë qytetarët pa dallim

përmes masave të ndryshme ekonomike të ndërmarrja, për t'i ndihmuar nënët, studentët e familjet, por edhe tejkalimin e krizave globale me të cilat jemi

përballur. Duke shprehur vëmendjen e qeverisë ndaj diasporës dhe kontributin ekonomik madhor të saj për vendin përmes investimeve në Kosovë dhe punës në programe të ndryshme, kryeministri theksoi dhe iniciativat e ndërmarrja nga qeveria për diasporën, si Shkolla për Diplomaci të Diasporës, platforma KosovaDiplo365, projekti Dritare për Investime të Diasporës e shumë të tjera. Kryeministri i falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për takimin dhe bashkëbisedimin e ngrötë. Në këtë takim kryeministri Kurti shoqërohej nga ambasadorja e Kosovës në Itali, Nita Shala dhe Konsulli i Përgjithshëm në Milano, Diamant Kastrati.

Ndalimi i importit nga Serbia, Sarrazin: Kosova në rrezik të përjashtimit nga CEFTA



PRISHTINË, 23 SHTATOR - Kosova mund të përballet me kërkesa për përjashtim nga Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore dhe ndëshkime të tjera nëse vazhdon t'i ndalojë importet serbe", tha Sarrazin. Më 5 shtator ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde, tha se Sarrazin, në vizitën e tij të dytë në Kosovë brenda një afati të shkurtër kohor, i kishte kërkuar kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, ta heqë ndalimin e vendosur në qershor 2023 për importin e produkteve të

vendit. "Në këmbim të heqjes së ndalimit, Kosova nuk do të përfaqësohej më zyrtarisht në kuadër të CEFTA-s nga misioni i OKB-së në Kosovë, UNMIK, por do të përfaqësohej vetë". Megjithatë, sipas tij, emri i saj do të shkruhet si Kosovë*, që të çonte në një fusnotë ku thuhet se statusi i Kosovës ende nuk është zgjidhur përfundimisht sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, duke reflektuar refuzimin e Serbisë për ta njojur atë si shtet të pavarur.

Deputetja e LDK-së kërkon nga Kurti t'u tregojë qytetarëve për tenderët sekretë

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Deputetja e LDK-së, Hykmete Bajrami, ka thënë se gjatë fundjavës që lamë pas kujdestarë për propagandë ishin Albin Kurti, Hekuran Murati dhe Armend Muja. Sipas saj, Albin Kurti, para se ta përmendë fjalën ekonomi, duhet t'u tregojë qytetarëve për 273 milionë euro të tenderëve sekretë. Ai, tha ajo, duhet të tregojë se si ka mundësi që për një rast korrupzioni në KEK, për t'u intervistuar qoftë edhe në cilësinë e dëshmitares, shkon



një zyrtare e lartë e LV-së, e cila nuk e ka asnjë funksion as në qeveri as në KEK. "Ajo ka funksion të lartë në parti. Çka duhet për të dëshmuar partia këtu? Edhe në cilësinë e dëshmitarëve do të ishte deri-diku e arsyeshme për t'u intervistuar, këshilltarët e Nagip Krasniqit, ata që punojnë në KEK se, mbështetët e kanë udhëzuar gabimisht, me u intervistuar ata që punojnë në divizion të prokurimit, njësia e kërkësës, zyra ligjore apo cilido punëtor i KEK-ut, por me u

intervistu dikush që asnjë lidhje zyrtare nuk e ka me KEK-un, qysh? Përveç kur prokurimi i 273 milionë eurove të tenderëve sekretë gatuhet në zyrat e LV-së, aty ku Dejona është zyrtarja më e lartë, siç tha Glauku, ajo i koordinon 'politikat profesionale' të LV-së. Albin, qytetarëve ju ke borxh këtë shpjegim, mandej flasim për ekonomi, sepse janë dy që po e gjerryjnë ekonominë tonë: korrupzioni dhe inflacioni", ka shkruar Bajrami në "Facebook".

Sumerët dhe qytetërimi i parë në botë

Përgatiti: Vesel MAKOLLI
(Pjes° nga libri Historia e historianit klasik Somerset Fry)

Në hartën e Lindjes së Mesme, shihen dy lumenj, Tigri dhe Eufrati. Të dytë rrjedhin pothuajse paralel nga Turqia, në një drejtë juglindor përmes Irakut, përuashkuan ne Kurna, duke formuar lumin që ne tani e quajmë Shat-el-Arab, i cili ka gjatësi rrëth 170 kilometra deri te derdhja e tij në Gjirin Persik. Fusha pjellore në mes të këtyre dy lumenjve quhet Mesopotamia (në greqisht do të thotë "midis lumenjve"). Këtu u vendosën njerëz me lëkurë të errët nga India veriperëndimore. Ata e quanin veten "njerëz me kokë të zezë, ose njerëz të Sumerit". Ata janë njerëzit e parë të qytetëruar në botë që lanë pas monumentet e shkruara.


Sumerët supozohet të kenë filluar të vendoseshin në Mesopotami rrëth vitit 5000 para Krishtit. Ata e kuptuan se metalin mund të punohej dhe ishin në gjendje të bënin shumë mjete të dobishme. Ata ishin fermerë të aftë, dhe në tokën pjellore të Mesopotamisë zhvilluan aftësitë e tyre bujqësore në një shkallë shumë të lartë. Ata korrin nga arat e tyre shumë më tepër sesa kishin nevojë, kështu që filluan të tregtonin me fqinjët e tyre më pak të zhvilluar.

Sumerët ishin gjithashtu ndërtues. Në Mesopotami, nuk kishte gur natyror dhe po ashtu pak kishte drunj dhe kjo ishte arsyaja pse ata filluan të bënin tulla, me të cilat ndërtuan shtëpitë e tyre të vogla.

Shumë shpejt sumerët zbuluan se disa vende fqinje kishin gurë natyralë dhe e treguan tepricën e të korrave të tyre me gurë, të cilët i përdornin për ndërtim në kombinim me tullat.

Sumerët shpikën rrötën e poçarit dhe e përdorën për të formuar një sërë enësh të dobishme dhe të bukura: tas, pjata, gota, vazo dhe kavanoza përmajtjen e ushqimit. Zbukuruan qeramikën e tyre me modele të mrekullueshme. Ata dinin gjithashtu të skalitnin, të përpunonin bakë, bronx, ar dhe gurë të çmuar.

Sumerët ndërtuan varka të vogla nga kallamishtë të thurura, të cilat i mbuluan me lëkurë kafshësh dhe i ljenin me katran. Ndërtimi i varkave ishte themeli i zhvillimit të tyre të mëtejshëm, që tani ishin në gjendje të lundronin nga një breg i Tigrin në tjetrin ose lart e poshtë Eufratit, dhe kështu ishin në kontakt shumë më të ngushtë me zonat fqinje. Me fjalë të tjera, sumerët gjetën një mënyrë për të komunikuar, e cila është shumë e rëndësishme për një qytetërim që sapo po zhvillohej. Lidhja midis vendbanimeve të para të vogla coi me kalimin e kohës në krijuimin e qyteteve të mëdha.



Historia e sumerëve sillet kryesisht rrëth qytet-shteteve. Kjo periudhë filloj rrëth vitit 3500 para Krishtit dhe zgjati rrëth një mijë e pesëqind vjet.

Në njëqind vitet e fundit, arkeologët gjatë gërmimeve në Mesopotami kanë zbuluar rrënojat e qytetit sumerian të quajtur Ur. Meqenëse qytetet e tjera si Eresh, Kish, Eridu dhe Lagash mendohet të jenë të ngjashëm, një pasqyrë e shkurtër e historisë sumere mund të jetet duke treguar historinë e qytetit të Urit.

Ur është ndërtua në bregun lindor të lumit Eufrat. Gërmimet kanë treguar se qyteti ishte i rrethuar nga një mur i lartë tullash dhe një kanal i gjérë që e rrethonte e që përdorej përmbrnjte dhe përrafiqe. Në lumë kishte një port për anijet tregtarë që sillnin mallra nga vendbanimet e tjera përgjatë Eufratit.

Vetë qyteti ishte i kryqëzuar me rrugë të ngushta të shtruara me tulla të pjekura nga dielli. Përgjatë rrugëve kishte shtëpi, dyqane dhe ndërtesa publike. Në shumë mënyra, shtëpitë sumere ngjanin me tonat, por nuk kishin dritare, pasi që xhami nuk njihet ende.

Përafërsisht në qendër të Urit qëndronte një tempull i madh në formën e një kulle, i quajtur zigurat. Sumerët besonin se perënditë qeverisnin forcën natyrore si toka (Euli), qelli (Anu), uji (Ea), dielli (Shamash) dhe hëna (Nanar). Çdo qytet sumerian kishte perëndinë e tij të veçantë, por gjithashtu respektonte perënditë e tjera. Zoti suprem i qytetit të Urit ishte Nanari dhe i qytetit të Erisit perëndia Ea. Tempulli i madh në

Ur, kushtuar perëndisë Nanar, ishte vendi kryesor ku ai adhurohej.

Në tempullin e Urit ishte një statujë e madhe e perëndisë Nanar. Ajo mbështetet në tri bazamente tullash dhe arrihet me shkallë. Ne e dimë se një nga mbretërit e parë sumerianë e ndërtoi atë tempull, sepse disa prej tullave mbajnë emrin e tij. Perëndia Nanar u nderaua gjithashtu në shumë tempuj më të vegjël përreth qytetit, dhe kishte gjithashtu disa tempuj të vegjël kushtuar gruas së tij Ningal.

Njerëzit në Sumeri ishin të ndarë në tri klasa kryesore. Priftërinjtë, zyrtarët dhe ushtria përfaqësonin klasën më të lartë shoqërore. Klasa e mesme përfshinte tregtarët, buqit dhe zejtarët, ndërsa klasa e fundit përbëhej nga skllëvërit. Njerëzit më të rëndësishëm ishin priftërinjtë, sepse konsideroheshin shërbëtorë të Zotit.

Të sumerët, viti llogaritej sipas lëvizjes së hënës; kishte dyndhëjtë muaj të cilët u ndanë në ditë dhe orë. Megjithatë, muajt kishin vetëm tridhjetë ditë secili, që korespondonte me një vit prej 360 ditësh. Në këtë kontekst, për të përshtatur plotësisht stinët në kalendar, priftërinjtë shpesh lajmëronin se vitit aktual do t'i shtohej edhe një muaj tjetër.

Në të kaluarën më të hershme të Sumerisë, nuk kishte mbretë dhe qytetet drejtosheshin nga priftërinjtë e lartë. Por, ndërsa qytetet u zhvilluan dhe barra e menaxhimit të qytetit u bë shumë e rëndë për një prift, ata filluan të zgjedhnin një njeri të

shquar nga kleri për të menaxhuar punët e qytetit. Institucioni i mbretërisë buron prej sumerëve. Mbreti menaxhonte punët shtetërore që nuk kishin lidhje me tempullin.

Vulat bëhen në prej balte ose guri, alabastri ose fildishi dhe të gdhendura me figura perëndish, kafshësh ose njerëzish. Shumë nga vulat e gjetura janë jashtëzakonisht të bukurat.

Sumerët kishin një shkrin shumë të pazakontë të quajtur kuneiform. Rrëth 3500 vjet para Krishtit, vizatoni piktogramë ose gdhendnët konturat e objekteve në pllaka balte me "penë" kallami. Këto tabletë më pas u pjekën dhe u bënë pothuajse të pathyeshme. Një numër i madh pllakash të zbuluara në Ur dhanë një pamje të gjallë të jetës sumere. Piktogramet evoluuan në një përzierje figurash dhe simbole të përfaqësonin shqiptimin e rrojjeve. Së fundi, sumerët kishin një lloj shkrimi që përfshinte rrëth 600 simbole.

Një shënim sumerian, i ruajtur deri më sot, thotë: "Për Nanarin, mbreti i tij është Ur-Nanu, njeriu i fuqishëm, mbreti i Urit, mbreti Sumeri dhe Akkadi, gërmuan një kanal të madh, kanalin e tij të dashur".

Ndërsa numri i qyteteve në Eufrat dhe Tigër rrjet, disa qytete më të pasura dhe më të fuqishme sumere u përpokojnë të nënshtronin fqinjët e tyre nën sundimin e tyre. Kështu lindi një sërë e dinastive që kishin pushtetin suprem në Sumer. Nuk është mundur të paraqitet një pemë familjare e plotë e dinastive sumere. Por, megjithatë, e dimë për disa

sundimtarë. Nga rrëth 2700 deri rrëth 2280 para Krishtit, Uri ishte qyteti kryesor. Me zbulimin e varrit të mbretëreshës Shab-Ad, që banonte aty, nga shkëlqimi dhe pasuria e atij varri mund të themi me shumë siguri se ajo ishte gruaja e një mbreti të fuqishëm. Ndër gjërat e tjera të varrosura me të ishte një harpë e zbukuruar me kokë demi dhe e veshur me guaska.

Është e mundur që rrëth vitit 2370 para Krishtit, fqinji i fuqishëm Sargon I, marshoi në Sumeri dhe e pushtoi atë. Ai mundi mbretërit e Urit, Lagashit dhe qyteteve të tjera, dhe për njëqind e njëzet vitet e ardhshme familja e tij sundoi sumerët dhe fqinjët e tyre, amorejtë dhe akadianët.

Nipin e Sargonit, Naramsini, i quajtur Mbreti i Katër Pjesëve të Botës, e mundi ushtria sumere nga Uri. Edhe një herë, Uri qëndroi në krye të qyteteve sumeriane, nën një dinasti të re, por para vitit 1950 para Krishtit komet fqnje filluan të sulmojnë qytetet sumere. Fuqia e sumerëve ishte dobësuar shumë dhe paralajmërohej fundi i forcës së tyre ushtarake. Qytetërimi sumer nuk u shemb, por u bashkua me atë babilonas, i cili përmirësoi më tej të gjitha tiparet e tij më të mira. Sumerët arritën një nivel të lartë organizimi juridik dhe shoqëror në kohën kur Evropa ishte e banuar nga njerëz të epokës se neolitit, të cilët ende nuk ishin të qytetëruar (civilizuar).



Januzi pasi merr çmimin 'Ylli i javës': Llapi lufton për titull



"Epoka e re"

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Skuadra e Llapit arriti tri pikë në përballen ndaj Ferizajt falë golit të shënuar nga sulumes me përvojë të madhe Ahmed Januzi.

Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsor i Superligës, Albi Mall, e kanë dhënë çmimin "Ylli i javës" për ish-sulmuesin e Kombëtares së Shqipërisë. Vlerësimi i më të mirit të javës së gjashtë në elitë është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit në përbërje të Enes Shoshollit, Bujar Gutës dhe Avni Shalës. Ky komision vendosi që

çmimi "Ylli i javës" për xhiron e gjashtë t'i jepet Januzit, i cili për 78 minuta të kaluara në fushë ishte lojtari kyç i Llapit. Ai shënoi golin e vetëm në ndeshje, duke ia mundësuar ekipe të tij të arkëtojë pikë të plota në ndeshjen në transfertë kundër FC Ferizaj (0-1). Januzi u shpreh i lumtur që u vlerësua më i miri i javës. Ai tha se kjo fitore i jep motiv edhe më të madh për ndeshjet e radhës. Sulmuesi edhe një herë ka ripërsëritur se skuadra e Llapit synon titullin e kampionës në Superligë. "Përballja me Ferizajn ishte një ndeshje shumë e vështirë për shumë arsy. Ferizaj është një

kundërshtar që u bënë probleme ekipeve, por është e rëndësishme që ne synimin tonin e arritëm, morëm pikët e plota. Kjo fitore besoj na motivon për ndeshjet e ardhshme që do t'i zhvillojmë në Podujevë. Është gjithmonë kënaqësi të shpallesh më i miri i xhros, por kjo nuk është meritë vetëm e imja, është e klubit dhe e bashkëlojtarëve, me të cilët është e rëndësishme të funksionojmë si grup. Atmosfera në ekipo tonë është shumë e mirë. Synimi ynë është titulli kampion dhe do të bëjmë më të mirën ndeshje pas ndeshje", ka thënë Januzi përfaqen zyrtare të FFK-së.

KB Peja sonte përballet me Maroussin

PEJË, 23 SHTATOR - Peja në mesjavë do t'i zhvillojë dy ndeshjet kualifikuese për FIBA Europe Cup. Peja do të ndeshet me skuadrën Maroussi, ndeshje të cilat zhvillohen më 24 dhe 26 shtator. Të dy takimet do të luhën në Greqi për shkak të problemeve në palestrën

"Karagaçi" në Pejë. Ndeshja e parë zhvillohet sot (e martë) nga ora 19:30, kurse sfida e dytë zhvillohet të enjten nga ora 19:30. Pejanët synojnë t'i kalojnë kualifikueset dhe të janë pjesë e grupeve në FIBA Europe Cup, ashtu si edhe në edicionin e kaluar, kur kishin paraqitje mjaft të mira në

grupe me dy fitore dhe katër humbje. Pjesë e grupeve të FIBA Europe Cup është konfirmuar Trepça, ndërsa më 27 shtator do të dihen përfundimisht 40 skuadrat që do t'i formojnë grupet përfundimisht.

SHKURT

Zhegrova sërisht në formacionin e javës në Ligën 1

Edon Zhegrova është duke kaluar nëpër një formë të mirë. Ylli nga Kosova realizoi dy gola në barazimin 3-3 të Lilles ndaj Strasbourgut të shtunën. Zhegrova hyri në formacionin e javës, madje me notën më të lartë nga të gjithë. 8.9 ishte nota nga Sofascore për yllin e madh në fundjavën që lamë pas.

Formacioni: Rulli, Teze, Ndayishimiye, Sagnan, Bard, Zhegrova, Savanier, Toliso, Guessand, Adams, Moukoko.

Shkolla 'Zidane' shkëlqen në Basel, fiton vendin e parë

Talentët nga Kosova të grupmoshave U9 kanë arritur ta fitojnë vendin e parë në turneun dyditor në Basel të Zvicrës. Futbollistët të Shkollës së Futbollit "Zidane", të udhëhequr nga trajneri i mirënjohur Muhamed Dragusha, mposhtën disa prej ekipeve më të mira helvetike, duke treguar performancë të shkëlqyer. Gjatë gjithë garës këta futbollistë treguan nivel të lartë të lojës, duke mposhtur rivalët me teknikë dhe përkushtim. Madje paraqitja e të vegjelëve në fushën e blertë la një përshtypje të jashtëzakonshme për shikuesit. Fitorja e ketij turneu të madh në Basel është një vazhdimësi e natyrshme e suksesit që ekipi ka arritur para pak muajsh në Shkodër dhe Durrës, duke rrëmbyer trofeun e turneve edhe në këto dy qytete. Këto janë vetëm disa prej suksesave të futbollistëve U9 të FC Zidane. Kapituj të rinj në historinë e futbollit në të ardhmen pritet të shkruhen nga Diell Shatrolli, Lek Krasniqi, Mal Tmava, Kaon Dibrani, Reis Shala, Ari Celina, Nil Dedinca, Aron Sheholli, Art Kelmendi e Art Rrahimi.

Lëndimi i Ter Stegen, Berisha në listën e Barcelonës

Lëndimi i Marc ter Stegenit është një pengesë e madhe për FC Barcelona. Portieri gjerman ka pësuar këputje të plotë të tendinit patellar në gjurin e djathtë dhe pritet të jetë jashtë fushave për tetë muaj, duke lënë Inaki Williams portierin e vetëm të ekipe të parë. Barça mund të drejtobet drejt tregut të agjentëve të lirë për ta mbuluar mungesën e Ter Stegenit, por nuk ka shumë kandidatë që mund ta përforcojnë portën e Barçës. Në mesin e portierëve të lirë, mediumi spanjoll, "Mundo Deportivo", ka listuar edhe portierin shqiptar Etrit Berisha, 35-vjeçar. Në mesin e të përmendurve janë edhe: Keylor Navas, Jordi Masip, Edgar Badia, Jiri Pavlenka, Loris Karius, Tomas Vaclik, Tomas Koubek, Alexandre Letellier dhe Kostas Lamprou.



Xhaka: Po pësojmë shumë gola

LEVERKUSEN, 23 SHTATOR - Jo çdo fitore vlen për Granit Xhakën. Autor i një asistimi në fitoren me përmbyssje 4-3 të Bayer Leverkusenit ndaj Wolfsburgut, "ylli" i "Aspirinave" shkund shokët e skuadrës, të cilët i kritikon për performancën e

dhuruar në ndeshjen e fundit. "Duhet të bëjmë autokritikë. Nuk është e mundur që ne të pësojmë tre gola në çdo ndeshje", ka thënë Xhaka. Bayer Leverkuseni ka pësuar 9 gola në 4 ndeshjet e para të Bundesligës, që "përkthehet"

ndryshe në mbrojtjen e katërt më të keqe për momentin në kampionat. "Kjo ka të bëjë me performancën e gjithë ekipit. Duhet të jemi shumë më të kujdeshëm në mbrojtje. Po pësojmë shumë. Me topin ne jemi aq të mirë si më parë.

Sigurisht, ne kemi cilësinë për të shënuar 10 gola për ndeshje. Kjo është shumë e mirë, por nuk më intereson. Dua të di nga shokët e skuadrës pse nuk po luajmë të bashkuar në fazën mbrojtëse", ka shtuar Xhaka.



Barça me kamp në Prishtinë, drejtori: Ky vend ka shumë talentë të futbollit

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Nga 20 deri më 24 tetor në Prishtinë do të mbahet kampi i njërit prej klubeve më të mëdha në botë, Barcelonës. Qëllimi kryesor i këtij kampi është zbulimi i fëmijëve të talentuar në futboll që pastaj do ta kenë mundësinë e provimit edhe te klubit katalanas.

Drejtori i Barcelonës për këtë kamp në Kosovë, Diego Perreira, ka thënë për "KosovaPress" se Kosova është vend që ka numër të madh të talenteve dhe se duhet të bëhet vetëm një punë më e madhe për zbulimin e tyre. "Kam parë ndeshje futbollit këtu në Kosovë, të meshkuve dhe femrave. Jam i sigurt që keni shumë talentë. Është vetëm një çështje e zhvillimit të talentit. Këto lloj iniciativash ndihmojnë në zhvillimin e këtij lloji talenti", ka shtuar ai.

Bardh Krasniqi, menaxher i piarat të këtij programi për Kosovë, theksoi se qëllimi kryesor i këtij kampi është zbulimi i fëmijëve që kanë talent në futboll dhe të cilët pastaj do ta kenë mundësinë t'i tregojnë aftësitë e tyre edhe në fazat provuese në Barcelonë. "Ky është kamp i akademisë së



Barcelonës i cili do të mbahet në Kampin Nacional në Hajvali, aty ku ushtronjë edhe përfaqësueset tona. Do të hapet nga 20 deri më 24 tetor. Aty do t'i kemi maksimalisht, për shkak se Barcelona i ka disa kriterie për të mos shkuar në sasi, por të fokusohemi në kualitet dhe e dimë që Barcelona atë e bën më së miri. Kështu që prej 20 deri më 24 tetor do ta kemi kampin zyrtar të Barcelonës në Kosovë, përkatësisht në Prishtinë. Pas fazës së kampit do të kalojmë në përzgjedjen e talenteve e cila do të bëhet prej stafit specifik të Barcelonës. 30 prej fëmijëve të

talentuar do të bartën në Barcelonë", ka theksuar Krasniqi. Perreira theksoi se talentet që do të përzgjidhen do të kenë një përvojë unlike në Barcelonë pas kampit në Kosovë. "Objektivi kryesor nga klubit dhe nga ne është t'u japi fëmijëve të Kosovës mundësinë të shijojnë një përvojë unlike, duke pasur këtu për një javë trajnerë të klubit të futbollit Barcelona, pastaj kemi mundësinë të stërvitimi sipas metodës, dhe në vlerat e klubit të futbollit të Barcelonës, i cili është një klub unik në botën e futbollit, një klub ndryshe, dhe krenar që është kaq i ndryshëm", ka deklaruar Perreira.

Alcaraz: Shumë ndeshje, ndonjëherë kam dëshirë të mos luaj

MADRID, 23 SHTATOR - Jo vetëm futbollistët, por edhe tenistët po ankohen gjithnjë e më shumë në lidhje me shtimin e numrit të turneve dhe ndeshjeve, çfarë e bën thuajse të pamundur pjesëmarrjen në seçilin prej tyre. Kjo bën që shpesh tenistët të lënë pikë rrugës, duke mos mbrojtur dot fitoret e një viti më parë. Ai që ka ngritur zérin është spanjollë Carlos Alcaraz, numri tre në botë, që nga München, ku po luan në Laver Cup, lëshoi alarmin: "Ne luajmë shumë dhe kjo na detyon të përballemi me probleme fizike. Ato janë frika ime e vëtme". Më tej, Alcaraz ka shtuar, duke akuzuar drejtuesit e ATP-së: "Disi ata do të na vrasin duke luajtur kaq shumë. Në këtë



fazë, shumë tenistë të mirë rrezikojnë t'i humbasin turnetë e tyre për shkak të lëndimeve". "Ndonjëherë ndodh që nuk dua të shkoj dhe të luaj një turne. Nuk gënjej kur them se jam ndier kështu disa herë. Kam thënë

vazhdimisht se luaj tenisin tim më të mirë kur mund të buzëqesh dhe të argëtohem në fushë", ka thënë Alcaraz, që këtë vit ka luajtur deri më tanë 50 ndeshje, duke fituar 41 dhe duke humbur 9.

PSG-ja refuzon ta paguajë bonusin ndaj Mbappes

Paris Saint Germain refuzon të paguajë një bonus besnikëri për ish-sulmuesin Kylian Mbappe, që verën e këtij viti la Francën dhe zgjodhi të kalojë si lojtar i lirë te Real Madrid. Sipas gazetës "Le Parisen", PSG-ja po refuzon t'i paguajë Mbappes shifrin prej 55 milionë eurosh që ai kërkon nga ish-klubi i tij. Një gjë e tillë është

konfirmuar nga klubti me një deklaratë. "PSG ka bërë ankim kundër vendimit të komisionit të LFP. Nuk është vetëm çështje e qëndrimit ligor të klubit, i cili është plotësish i justifikuar. Është, gjithashtu, çështje integriteti, ndershëmëri e ruajtjes së vlerave dhe respektit për klubin parisien dhe tifozët, gjë që

është më e rëndësishme se çdo lojtar. Nga pikëpamja ligore dhe faktike, lojtarët ka dhënë angazhime publike dhe private, të cilat i kërkohet klubit t'i përmblushë. Përveç kësaj, lojtarët ka marrë privilegje të paprecedentë nga klubit gjatë shtatë viteve të tij në Paris. Klubi mezi pret që këto detyrime

themelore dhe të padiskutueshme të respektohen në rastin e duhur nëse lojtarët vendosat ndjekë këtë çështje, gjë që do të vinte në pikëpyetje reputacionin e tij", thuhet në reagimin e PSG-së. Më herët, Liga Profesionale Franceze e Futbollit (LFP) i detyroi parisienët ta paguajnë

borxhin ndaj lojtarit. Ata caktuan një afat prej tetë ditësh për pagesën e cila tashmë ka skaduar. Mbappe beson se klubti i ka borx 55 milionë euro në përpunje me kontraten e tij të fundit me klubin e Ligës 1. PSG-ja këmbëngul se lojtarët pranojnë të hiqte dorë nga kjo tarifë pasi vendosi të langojë nga klubti si lojtar i lirë në verë.

SHKURT

Ter Stegen, tetë muaj larg fushës së blertë

Një lajm i keq vjen për tifozët e Barcelonës. Portieri Marc-Andre ter Stegen do të jetë larg fushës së blertë për tetë muaj. "Gardiani" gjerman mbrëmë pësoi një lëndim në sfidën ndaj Villarealit, ku i përlotur lëshoi fushën në pjesën e parë. Klubi nga 'Camp Nou' përmes një njoftimi ka konfirmuar se Ter Stgen ka një këputje të tendinës në gjurin e djathët dëhe nuk do të kthehet në fushë për tetë muaj. "Testet e bëra te lojtarë i ekipit të parë Marc ter Stegen konfirmojnë se ai ka pësuar një këputje të plotë të tendinit patellar në gjurin e djathët. Ai do t'i nënshتروhet një operacioni të hënën pasdite. Portieri i Barçës është dashur të largohet nga fusha në 'Estadio de la Ceramica' në fund të pjesës së parë. Gjermani ishte dukshëm i lënduar dëhe u zëvendësua shpejt nga Inaki Pena. Këtë sezoni kapiteni i Barçës ka zbritur gjithmonë në fushë. Paraqitja e tij kundër Villarrealit ishte e 289-ta me fushellët e skuadrës blaugrana dëhe e kaloi portierin legjendar Antoni Ramallets në vendin e tretë në renditjen e të gjitha kohëve të portierëve më të paraqitur për Barcelonën", thuhet në njoftimin e Barcelonës.

Guardiola: Kundër Arsenalit morëm atë që meritonim

Trajneri i Manchester Cityt, Pep Guardiola, duke folur për "SkySports", e analizoi ndeshjen e barazuar 2-2 kundër Arsenalit në këtë mënyrë: "Nuk e di se sa lojtarë (të Arsenalit) kishin ngërçë, por kjo padyshim mund të ndodhë në një lojë sfiduese. Ne kishim Ruben (Dias), Manuel (Akanji), Erling (Haaland), por kur ata sulmonin kishin Declan Rice, William Saliba, Gabriel, Riccardo Calafiori, kështu që është shumë e vështirë. Ishin dhjetë lojtarë atje, në mbrojtje. Në fund morëm atë që meritonim", ka thënë Guardiola, i cili foli edhe për humbjen e kohës nga Arsenali. "Ndoshta do të kisha bërë të njëjtën gjë edhe unë me dhjetë lojtarë. Duhet të pyesni Mikel (Arteta) se cila ishte taktika. Ata ishin të mirë me topat e gjatë për Kai Havertz, i cili është kaq i fortë. Në fund patëm durim, patëm rastet dëhe shënuam kaq".

Fonseca: Fitore në një ndeshje dhe çast të rëndësishëm

Trajneri i AC Milan, Paulo Fonseca, është i lumtur me fitoren që e arriti skuadra e tij në derbi ndaj Interit (2-1). Ai ka thënë se që një kohë të gjatë Milani nuk ka krijuar raste aq shumë ndaj Interit dhe se kjo fitore ishte plotësish et meritor. "Ishite një ndeshje e rëndësishme, si të gjitha ndeshjet derbi. Nuk fitonim prej kohësh, por kjo ishte et rëndësishme edhe për momentin që po kalonim. Djemtë zbritën në fushë me shumë guxim, et merituam fitoren pasi kisha shumë kohë që nuk shihja një skuadër e cila të krijonte kaq shumë raste kundër Interit", ka thënë Fonseca, i cili ka folur edhe për të ardhmen. "Për mua, në aspektin personal, nuk ndryshon asgjë, pasi unë nuk shikoj dhe nuk dëgjoj se çfarë thuhet. Sigurisht, të fitosh një derbi është gjithnjë speciale. Tani do të jetë një javë ku do të kemi më shumë besim. Është et rëndësishme që djemtë të janë të qetë dhe të besojnë në atë që bëjnë. Kjo ishte një fitore për ata", u shpreh Fonseca.

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

[facebook](https://www.facebook.com/gjejpuneshpejte) www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë-Ministraskvo Pravde-Ministry of Justice

Ajencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar / Agencja za Upravljanje Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom/ Agency for Administration of Sequestered and Confiscated Assets

Ftesë për Ankand Publik Rishpallje

Datë 24.09.2024

Referenca: AAPSK – 010/2024

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje mallin si në vijim, sipas lëndës së paraqitura më poshtë:

Nr	Përshkrimi	Sasia/copë	Çmimi Fillestar/copë	Çmimi nga ofertuesi	Çmimi total €
1	VW Passat 3B, viti i prodhimit 2000, dizel, ngjyrë e zezë-për pjesë	1 copë / për pjesë	1,080.00€		
2	Golf III, viti i prodhimit 1995, benzin, ngjyrë e kuqe-për skrap	1 copë/ për skrap	176.98€		
3	Golf II, viti i prodhimit 1985, dizel ngjyrë kuqe- për skrap	1 copë/ për pjesë	213.44€		
4	Citroen Berlingo,viti i prodhimit 2006,dizel, ngjyrë e hirë,pa targa	1 copë	300.00€		

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e myllur në zarf duhet të dorëzohen më së largu deri më 01.10.2024 në ora 11:00h, në lokalet e AAPSK-së, në adresën: Depo e Agjencisë Rr. Bajram Bahtiri (ish Kazerma e FSK-se) fshati Llukar KK Prishtinë, kurse pasuritë me numra rendor:4 mund ti shikoni me datë 30.09.2024 në Qendren Korrektuese Smrekovicë në ora 10:00-11:00

Të interesuarit mallin mund ta shikojnë me datë: 01.10.2024, prej orës 10:00-11:00 në Depon e Agjencisë në fshatin Llukar KK Prishtinë

Pasurit e sekuestruar ose te konfikuara ne këtë procedure shitje procedohen për shitje, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Fitues do të jetë oferta e ofruar me çmimin më të lartë. Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr. 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-se në: <https://aapsk.rks.gov.net> apo <https://md.rks.gov.net/> Në zarf të shkruehet për: AAPSK, Sektori i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 11:00. Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, katër 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 67 254

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Gazmen Kadriaj shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme "Ymer Prizreni" Prizren.
- Luan Berisha shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme "Ymer Prizreni" Prizren.
- Nadire Mehmeti nga Skenderaji shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t. "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.
- Alban Krasniqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13 dhe diplomën e sh.m.e. "Kadri Kusari".
- Zana Rama nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4. dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", katër tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrëthi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m², dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fludi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA
1992

